

SISTEMI I DREJTËSISË NË MITROVICË

Gjendja para dhe pas dorëheqjes masive të gjyqtarëve,
prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës

Shkurt 2024



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë



SISTEMI I DREJTËSISË NË MITROVICË

Gjendja para dhe pas dorëheqjes masive të gjyqtarëve,
prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të
Kosovës

PASQYRA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE.....	7
1.1. Metodologjia	9
2. GJENDJA E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË MITROVICË PARA DHE PAS DORËHEQJEVE MASIVE	10
2.1. Integrimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës në sistemin e drejtësisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës.....	10
2.2. Konteksti i dorëheqjes masive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës në rajonin e Mitrovicës.....	11
2.3. Masat e marra për të adresuar situatën pas dorëheqjes masive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës.....	13
2.3.1. Gjkata Themelore e Mitrovicës.....	13
2.3.2. Divizioni i Gjykatës së Apelit të Mitrovicës së Veriut	13
2.3.3. Prokuroria Themelore e Mitrovicës	14
2.3.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës.....	14
2.4. Krahasimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë në Mitrovicë para dhe pas dorëheqjeve masive	15
2.4.1. Struktura e personelit	15
2.4.2. Ngarkesa me lëndë.....	17
2.4.3. Lëndët e pazgjidhura.....	21
2.4.4. Seancat e shtyra.....	24
2.5. Ndikimi i dorëheqjeve masive në funksionimin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë	25
3. PËRFUNDIME	29

LISTA E SHKURTESAVE

Divizioni i GJA-së	Divizioni i Gjykatës së Apelit të Mitrovicës së Veriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
GJTH MI	Gjykata Themelore e Mitrovicës
PTH MI	Prokuroria Themelore e Mitrovicës
OSBE	Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Më 7 nëntor 2022, sistemi i drejtësisë në rajonin e Mitrovicës përjetoi një zhvillim të paprecedentë kur, pas pesë viteve të funksionimit të suksesshëm të gjyqësorit dhe prokurorisë së integruar siç është përcaktuar nga Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, e nënshkruar në prill 2013 në Bruksel ("Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013"), të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ të komunitetit serb të cilët ishin integruar dhënë dorëheqje masive nga postet e tyre ("dorëheqja masive").

Ky raport jep një pasqyrë faktike të funksionimit të sistemit të drejtësisë në Mitrovicë, duke krahasuar situatën para dhe pas dorëheqjes masive të të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të komunitetit serb të Kosovës nga postet e tyre në gjyqësorin dhe prokurorinë e integruar në Rajonin e Mitrovicës.

Raporti shqyrton të dhënat statistikore në dispozicion publik dhe vrojtime observimet faktike lidhur me funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës para dhe pas dorëheqjes masive për t'i identifikuar ndikimet e mundshme në performancën dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë, me fokus në respektimin e parimeve të sundimit të së drejtës dhe standardeve të gjykimit të drejtë.

Pas dorëheqjes masive, kapacitetet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për të administruar drejtësinë në kohë dhe me efikasitet është zvogëluar në masë alarmante për shkak të mungesës së papritur dhe të konsiderueshme të personelit.

Siç konfirmon raporti, në bazë të të dhënave statistikore publike të mbledhura, të krahasuara dhe analizuara, ky kapacitet i reduktuar i Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ka çuar në ulje të shkallës së trajtimit të lëndëve të llogaritur ndërmjet lëndëve të pranuar rishtazi dhe lëndëve të zgjidhura; kjo rënie është pasqyruar në rritje evidente të numrit të përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura, duke ndikuar në shpejtësinë e ndjekjes penale dhe të procedimeve gjyqësore.

Dorëheqja masive ka kontribuar edhe në rritjen numrit të seancave të shtyra në lëndët gjyqësore. Menjëherë pas dorëheqjes masive, nuk është mbajtur asnjë nga seancat në lëndët që u ishin caktuar gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës. Një faktor tjetër që kontribuon në rritjen numrit të seancave të shtyra në

lëndët penale është mungesa e vazhdueshme e personelit në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, veçanërisht në Departamentin e Përgjithshëm të saj.

Mbyllja e objekteve në degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok dhe të Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut kufizoi qasjen fizike në gjykatë dhe ndikoi në disponueshmërinë e shërbimeve gjyqësore për banorët. Gjithashtu, disa nga masat zbutëse të ndërmarra nga Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe Prokuroria Themelore e Mitrovicës në përgjigje ndaj dorëheqjes masive mund të kenë imponuar sfida në të drejtën e palëve për t'iu qasur drejtësisë në mënyrë efektive dhe të barabartë.

Duke u bazuar në gjetjet, raporti konstaton se dorëheqja masive ka pasur një efekt të konsiderueshëm negativ në procesin e integritetit të gjyqësorit dhe prokurorisë, duke çuar në pasoja të rënda për të drejtat e banorëve në rajonin e Mitrovicës, veçanërisht në të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe për qasje në drejtësi, dhe thekson nevojën për të rivendosur funksionimin efikas dhe të drejtë të sistemit të drejtësisë në Mitrovicë.

1. HYRJE

Sistemi efektiv dhe i qasshëm i drejtësisë është thelbësor për sundimin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e ndjenjës së sigurisë dhe besimit mes qytetarëve.

Në kuadër të mandatit të vet, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), monitoron dhe raporton mbi punën e sistemit të drejtësisë në Kosovë për të siguruar pajtueshmërinë e tij me parimet e sundimit të së drejtës dhe standardet e të drejtave të njeriut.

Nga viti 2008 deri në vitin 2017, sistemi i drejtësisë në rajonin e Mitrovicës ka funksionuar vetëm me kapacitet të kufizuar, duke mos ua mundësuar banorëve të të gjitha komuniteteve ushtrimin apo mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre para gjykatave.

Marrëveshja e Brukselit hapi rrugën për integrimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Modalitetet e integritit janë përcaktuar në Marrëveshjen për Drejtësi ("Marrëveshja për Drejtësi e vitit 2015") e nënshkruar në shkurt të vitit 2015, duke përcaktuar juridiksionin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.¹

Që nga zbatimi i integritit në tetor 2017, Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe degët e saj në Leposaviq dhe Zubin Potok, Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut dhe Prokuroria Themelore e Mitrovicës kanë administruar me sukses drejtësinë me gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ serbë të Kosovës të cilët ishin integruar.

Në nëntor të vitit 2022, pas vendimit të 5 nëntorit që përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës në veri të largoheshin nga institucionet, më 7 nëntor, të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ serbë të Kosovës dhanë dorëheqje nga postet në gjyqësorin dhe prokurorinë e integruar në rajonin e Mitrovicës. Kjo dorëheqje masive krijoi një situatë të jashtëzakonshme me ndikim të drejtpërdrejt në funksionimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.

¹ Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan, Platforma Dialog-Info. *Marrëveshja e Drejtësisë*, 2015. Në dispozicion në: <https://dialogue-info.com/wp-content/uploads/2020/09/Agreement-on-Justice-9-February-2015.pdf> (qasur më 15 shtator 2023).

Ky raport ka për qëllim t'i pasqyrojë ndikimet e mundshme të dorëheqjes masive dhe gjendjes së jashtëzakonshme që ende vazhdon në performancën e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë, karshi parimeve të sundimit të së drejtës dhe standardeve të gjykimit të drejtë.

Analiza e raportit mbulon tri fusha kryesore. Së pari, raporti ofron një pasqyrë të shkurtër të procesit të integritetit të gjyqësorit dhe prokurorisë në rajonin e Mitrovicës, i kryer në tetor të vitit 2017 dhe kontekstin e dorëheqjes masive në nëntor të vitit 2022. Së dyti, ai krahason funksionimin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë para dhe pas dorëheqjes masive; kjo bazohet në të dhënat statistikore dhe observimet faktike për qëllime të raportit. Së treti, raporti shqyrton ndikimet e mundshme të dorëheqjes masive dhe situatës së jashtëzakonshme mbi të drejtën për qasje në drejtësi, të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, si dhe shqetësime të tjera të vrojtuar lidhur me të drejtat e njeriut. Në fund, raporti paraqet një sërë konkluzionesh në lidhje me ndikimet e identifikuara.

1.1. Metodologjia

Mbledhja e të dhënave për raportin bazohet në:

(i) Hulumtimin nga zyra të të dhënave përkitazi me funksionimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe degëve të saj në Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri dhe Zubin Potok, si dhe të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës për periudhën e raportimit nga janari 2022 deri në qershor 2023 (“periudha e raportimit”), që përfshin:

(a) raportet statistikore publike për punën e Gjykatave Themelore dhe Prokurorive Themelore të Kosovës në periudhën e raportimit të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokuroritë e Kosovës;

(b) raportet statistikore publike për punën në periudhën e raportimit të publikuara nga Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe Prokuroria Themelore e Mitrovicës;

(c) raportet e brendshme të OSBE-së dhe shënimet në dosje, si dhe artikujt relevantë të mediave në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë në rajonin e Mitrovicës gjatë periudhës së raportimit.

(ii) Takimet me përfaqësuesit e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe degëve të saj, Prokurorisë Themelore të Mitrovicës dhe Zyrës Rajonale të Odës së Avokatëve të Kosovës në Mitrovicë, si dhe me përfaqësues të gjyqtarëve serbë të Kosovës që kanë dhënë dorëheqje, të gjitha të mbajtura në korrik 2023.

Gjetjet e raportit bazohen në analizën sasiore krahasuese të të dhënave statistikore publike në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë në rajonin e Mitrovicës gjatë periudhës së raportimit, gjegjësisht, para dhe pas dorëheqjes masive, në veçanti numrin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ të caktuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe degët e saj, Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe shkallën e trajtimit, dhe numrin e lëndëve të pazgjidhura. Disa nga gjetjet e raportit janë ilustruar nga vrojtimitet e drejtpërdrejta të bëra nga monitoruesit gjykatave të OSBE-së gjatë seancave të monitoruara pas dorëheqjes masive.

2. GJENDJA E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË MITROVICË PARA DHE PAS DORËHEQJEVE MASIVE

2.1. Integrimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës në sistemin e drejtësisë së Kosovës në rajonin e Mitrovicës

Duke u bazuar në Marrëveshjen e Brukselit të vitit 2013 dhe Marrëveshjen për Drejtësinë të vitit 2015, gjyqtarët, prokurorët dhe stafi administrativ serbë të Kosovës kanë kryer integrimin e tyre në sistemin e drejtësisë së Kosovës më 24 tetor 2017. Përkatësisht, Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe degët e saj të sapoformuara në Leposaviq dhe Zubin Potok kanë pranuar caktimin e 25 gjyqtarëve serbë të Kosovës,² Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka pranuar caktimin e nëntë prokurorëve serbë të Kosovës³, dhe Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë të Veriut ka pranuar caktimin e pesë gjyqtarëve serbë të Kosovës.⁴

Integrimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës në sistemin e drejtësisë së Kosovës ndikoi dukshëm në krijimin e një sistemi funksional të drejtësisë në katër komunat veriore të Kosovës, duke çuar në pajtueshmëri më të madhe me parimet e sundimit të së drejtës dhe përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.⁵ Që nga integrimi, janë vërejtur zhvillime pozitive në funksionimin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë, duke përfshirë funksionimin efektiv dygjuhësh të gjykatës dhe prokurorisë. Vlen të përmendet gjithashtu bashkëpunimi shumë profesional dhe i çmuar ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ shqiptarë dhe serbë të Kosovës, zvogëlimi i numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe procedurat transparente gjyqësore, duke rezultuar në përparim të përgjithshëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimeve të sundimit të së drejtës.⁶

² 12 gjyqtare, 13 gjyqtarë.

³ Shtatë prokurore, dy prokurorë.

⁴ Një gjyqtare, katër gjyqtarë.

⁵ Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan.

⁶ Në mars të vitit 2020, monitoruesit e OSBE-së zhvilluan intervista me 16 akterë të drejtësisë nga rajoni i Mitrovicës, ku të gjithë i vlerësuan si të shkëlqyera marrëdhëniet profesionale ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ shqiptarë dhe serbë të Kosovës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, për vitin 2018*. Në dispozicion në:

Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2018_mbi_punen_gjykatave_Srb.pdf (gjyqesori-rks.org) (qasur më 9 nëntor 2023);

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, për vitin 2019*. Në dispozicion në:

9986_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2018_mbi_punen_gjykatave_Srb.pdf (gjyqesori-rks.org) (qasur më 9 nëntor 2023);

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, për vitin 2020*. Në dispozicion në:

23323_KGJK_Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2010_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf (gjyqesori-rks.org) (qasur më 9

2.2. Konteksti i dorëheqjes masive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës në rajonin e Mitrovicës

Në gjysmën e dytë të vitit 2022, situata politike në veri të Kosovës ishte e paqëndrueshme dhe e tensionuar.⁷

Më 28 tetor, Qeveria njoftoi për miratimin e vendimit për reregjistrimin e automjeteve me targa të Serbisë me emërtime të qyteteve të Kosovës (targat e lëshuara nga Serbia).⁸ Vendimi parashihte vërejtje dhe gjoba për drejtuesit e automjeteve me targa të Serbisë, të cilët nuk i regjistrojnë veturat e tyre në përputhje me vendimin.

Më 2 nëntor, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës (PK) për rajonin e veriut, Nenad Đurić, serb i Kosovës, njoftoi publikisht se policët serbë të Kosovës të PK-së që shërbejnë në rajonin e Veriut nuk do të zbatojnë vendimin për regjistrimin me faza të targave RKS.⁹ Të nesërmen, më 3 nëntor, PK-ja suspendoi Đurićin për “mosushtrim të kompetencave ligjore dhe moszbatim të vendimeve zyrtare”.¹⁰

Si reagim ndaj suspendimit të Đurićit, më 5 nëntor, pas takimit të përfaqësuesve politikë dhe institucionalë të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës në veri të Kosovës të mbajtur në Zveçan, Kryetari i Listës Srpska shpalli vendimin që përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës në veri të largohen nga institucionet e Kosovës (“takimi i 5 nëntorit në Zveçan”).

nëntor 2023); Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, për vitin 2021*. Në dispozicion në: [91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/91632_KGJK_Raporti_Statistikor_Vjetor_Gjykatave_2021.pdf) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 9 nëntor 2023).

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Osnovni sud u Mitrovici vodi na objavljivanje presuda*, 7 nëntor 2019. Në dispozicion në: *Osnovni sud u Mitrovici vodi na objavljivanje presuda* – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (gjyqesori-rks.org) (qasur më 13 nëntor 2023).

7 Hovenier, J. [@USAmbKosovo]. (2 gusht 2022). *SHBA-ja mirëpret vendimin e liderëve të Kosovës për të pezulluar përkohësisht zbatimin e masave të reciprocitetit për targat dhe dokumentet hyrëse/dalëse, të dyja masat janë plotësisht në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe ishin të koordinuara me komunitetin ndërkombëtar*. [Tweet]. X. Në dispozicion në: <https://x.com/USAmbKosovo/status/1554393408004816897?s=2> (qasur më 9 nëntor 2023);

Borrell, JF [@JosepBorrellF]. (18 gusht 2022). *Sot në mëngjes do ta thërras takimin e dialogut të nivelit të lartë Beograd-Prishtinë. Tensionet e fundit në veri të Kosovës kanë treguar sërish se është koha për të ecur përpara drejt normalizimit të plotë. Pres që të dy udhëheqësit të jenë të hapur dhe fleksibil për të gjetur gjuhën e përbashkët*. [Tweet]. X. Në dispozicion në: <https://x.com/JosepBorrellF/status/1560184533579927552?s=20> (qasur më 8 nëntor 2023);

Veprimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian, *Kosovë/Serbi: Deklarata e Përfaqësuesit të Lartë për zhvillimet e fundit*, 5 nëntor 2022. Në dispozicion në: *Kosovo/Serbia: Deklarata e Përfaqësuesit të Lartë për zhvillimet e fundit* | EEAS (europa.eu) (qasur më 8 nëntor 2023).

8 Qeveria e Kosovës, *Vendimi nr.05/103*, 28 tetor, 2022. Në dispozicion në: [ActDetail.aspx](https://www.rks-gov.net/ActDetail.aspx) (rks-gov.net); [engVendimet-103.doc](https://www.rks-gov.net/engVendimet-103.doc) (live.com) (qasur më 31 korrik 2023).

9 “Djurić konfirmon se policia e rajonit veri nuk do të lëshojë vërejtje”, KoSSev, 2 nëntor 2022. Në dispozicion në: *Gjurić konfirmon se policia e rajonit veri nuk do të lëshojë vërejtje* - KoSSev (qasur më 31 korrik 2023).

10 Policia e Kosovës, *suspendohet drejtori rajonal i Mitrovicës së Veriut*, 3 nëntor 2022. Në dispozicion në: *Suspendohet drejtori rajonal i Mitrovicës së Veriut* – Policia e Kosovës (qasur më 31 korrik 2023).

Pas këtij vendimi, më 7 nëntor, të gjithë gjyqtarët dhe personeli administrativ serbë të Kosovës të Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në gjyqësorin e integruar në rajonin e Mitrovicës. Më vonë të njëjtën ditë, të gjithë prokurorët dhe stafi administrativ serbë të Kosovës të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës kanë dhënë dorëheqje nga postet e tyre në prokurorinë e integruar në rajonin e Mitrovicës.

2.3. Masat e marra për të adresuar situatën pas dorëheqjes masive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës

2.3.1. Gjykata Themelore e Mitrovicës

Duke reaguar ndaj dorëheqjes masive dhe pas një sërë takimesh ndërmjet përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Gjykatës Themelore të Mitrovicës, më 9 nëntor, nënkryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës ia dorëzoi Kryesuesit të KGJK-së planin e përkohshëm të veprimit. Ai u fokusua në vazhdimin e punës së Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe degëve të saj pas dorëheqjes masive ("plani i përkohshëm i veprimit"), me masa konkrete për të adresuar situatën e jashtëzakonshme ekzistuese:

- (i) riorganizimin dhe funksionimin e departamenteve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës,
- (ii) identifikimin e lëndëve që do të transferohen në gjykata të tjera,
- (iii) riorganizimin e stafit profesional,
- (iv) riorganizimin e administratës.

Në bazë të planit të përkohshëm të veprimit, dy gjyqtarë shqiptarë të Kosovës nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore të Mitrovicës (GJTH MI) janë transferuar në Departamentin e Krimeve të Rënda të GJTH MI. Një gjyqtar shqiptar i Kosovës nga dega e GJTH MI në Vushtrri dhe një gjyqtar shqiptar i Kosovës nga Departamenti i Përgjithshëm i GJTH MI, Divizioni Civil, janë transferuar në Departamentin e Përgjithshëm të GJTH MI, Divizionin Penal. Katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës u caktuan për të trajtuar lëndët penale dhe civile në degët e GJTH MI në Leposaviq dhe Zubin Potok.

Në të njëjtën kohë, të gjithë gjyqtarëve u është ngarkuar detyra që t'u japin përparësi lëndëve me parburgim, lëndëve penale dhe civile të dhunës në familje, si dhe lëndëve që janë afër arritjes së afatit të parashkrimit.

Në përputhje me planin e përkohshëm të veprimit për adresimin e mungesës së personelit në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, gjithsej 81 lëndë të gjykatës janë identifikuar për t'u transferuar në gjykatat tjera themelore në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Pejë dhe Prizren.

2.3.2. Divizioni i Gjykatës së Apelit të Mitrovicës së Veriut

Më 7 nëntor 2022, Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë të Veriut (Divizioni i GJA-së) pushoi së funksionuari, duke i transferuar të gjitha lëndët në pritje nga Divizioni i GJA-së në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Gjykata e Apelit mori përsipër

27 lëndë penale të pazgjidhura dhe 160 lëndë civile të pazgjidhura që fillimisht i ishin caktuar Divizionit të GJA-së.¹¹

2.3.3. Prokuroria Themelore e Mitrovicës

Pas dorëheqjes masive, Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Kosovës vendosi për transferimin e përkohshëm të tre prokurorëve nga Prokuroria Themelore e Prishtinës dhe ajo e Ferizajt në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës (PTH MI), Departamentin e Përgjithshëm, meqë menjëherë pas dorëheqjeve masive, departamentit i kishte mbetur vetëm një prokuror shqiptar i Kosovës për të trajtuar të gjitha lëndët penale. Zbatimi i masës ka zgjatur nga data 15 nëntor 2022 deri më 15 maj 2023.

Më 23 maj 2023, në bazë të kërkesës së Kryeprokurorit të PTH MI, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) vendosi për transferimin e përkohshëm të dy prokurorëve nga Prokuroria Themelore e Ferizajt në Departamentin e Përgjithshëm të PTH MI për një periudhë prej gjashtë muajsh, duke filluar përkatësisht nga 23 maj dhe 5 qershor.

Për të adresuar mungesën e konsiderueshme të personelit, Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka marrë gjithashtu një masë për t'u dhënë përparësi lëndëve me paraburgim, lëndëve të dhunës në familje, lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, dhe lëndëve që janë afër arritjes së afatit të parashkrimit.

2.3.4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës

Deri në datën e këtij raporti, as KGJK dhe as KPK nuk kanë marrë vendim mbi dorëheqjet individuale të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës të paraqitura në nëntor të vitit 2022.

Më 28 korrik 2023, pas përfundimit të procedurave përkatëse disiplinore, KGJK ka nxjerrë vendime disiplinore ndaj tre gjyqtarëve serbë të Kosovës të cilët paraqitën dorëheqjet e tyre në nëntor 2022. Në bazë të këtyre vendimeve disiplinore, KGJK-ja ka shqiptuar dënim disiplinor të propozimit për shkarkim¹² ndaj dy gjyqtarëve serbë të Kosovës dhe dënim disiplinor të vërejtjes publike me shkrim¹³ ndaj një gjyqtari serb të Kosovës për shkelje disiplinore në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në takimin e 5 nëntorit në Zveçan.¹⁴

¹¹ Divizioni i Apelit në Mitrovicën e Veriut jofunksional, 187 lëndë barten në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, *Betimi për Drejtësi*, 14 janar 2023. Në dispozicion në: <https://betimiperdrejtesi.com/divizioni-i-apelit-ne-mitrovicen-veriore-jofunksional-187-lende-barten-ne-gjykatene-e-apelit-ne-prishtine/> (qasur më 31 korrik 2023).

¹² Ligji Nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 7 (1) (1.5.)

¹³ Ligji Nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, neni 7 (1) (1.2.)

¹⁴ Njërit nga gjyqtarëve serb të Kosovës i është shqiptuar dënim disiplinor edhe për pjesëmarrjen dhe fjalimin në tubimin publik të banorëve serb të Kosovës në qendër të Mitrovicës së Veriut më 6 nëntor 2022.

2.4. Krahasimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë në Mitrovicë para dhe pas dorëheqjeve massive

2.4.1. Struktura e personelit

Marrëveshja për Drejtësinë e vitit 2015 e përcakton strukturën e personelit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut dhe Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, duke saktësuar numrin dhe përkatësinë etnike të gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ të caktuar në këto institucione të drejtësisë.

Sipas tabelës së personelit bashkëngjitur në Marrëveshjen e Drejtësisë të vitit 2015, Gjykata Themelore e Mitrovicës do të funksiononte me 32 gjyqtarë shqiptarë të Kosovës dhe 34 gjyqtarë serbë të Kosovës, ndërsa Divizioni i Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut do të përbëhej nga dy gjyqtarë shqiptarë të Kosovës dhe pesë gjyqtarë serbë të Kosovës. Degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok do të kishin nga dy gjyqtarë serbë të Kosovës. Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës do të kishte nëntë prokurorë shqiptarë të Kosovës, përfshirë kryeprokurorin dhe nëntë prokurorë serbë të Kosovës.¹⁵

Gjatë dorëheqjeve masive, gjithsej 20 gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 110 anëtarë të personelit administrativ të Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe degëve të saj në Leposaviq dhe Zubin Potok kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre. Më konkretisht, në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kanë dhënë dorëheqje 17 gjyqtarë serbë të Kosovës, 65 serbë të Kosovës dhe një goran i Kosovës, anëtar i personelit administrativ. Në degën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq, dy gjyqtarë serbë të Kosovës dhe 20 anëtarë të personelit administrativ, serbë të Kosovës, dhanë dorëheqje. Në degën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Zubin Potok, një gjyqtar serb i Kosovës dhe 24 anëtarë të personelit administrativ serb të Kosovës dhanë dorëheqje.¹⁶

Në të njëjtën ditë, nga pozita e tyre dhanë dorëheqje edhe katër gjyqtarë serbë të Kosovës të Divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë e Veriut.

15 Grupi i Kërkimit të Politikave në Ballkan, Platforma Dialog-Info. *Shtojca e Marrëveshjes së Drejtësisë, 2015*. Në dispozicion në: <https://dialogue-info.com/wp-content/uploads/2013/04/integration-of-judiciary.jpg> (qasur më 15 shtator 2023).

16 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Gjyqtarët në detyrë*. Në dispozicion në: Në detyrë – Gjykata Themelore Mitrovicë (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 gusht 2023); Gjykata Themelore në Mitrovicë, Raporti i punës nr. 135/2022, 18 janar 2023. Në dispozicion në: 88198_GjTh_Mitrovica_Raporti_rregullt_punes_periudha_1_tetor_31_dhjetor_2022.pdf (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 gusht 2023).

Sa i përket personelit, dorëheqja masive nuk ndikoi drejtpërdrejt në degët e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Skenderaj dhe Vushtrri, pasi këto degë të gjykatave nuk kishin gjyqtarë të integruar serbë të Kosovës dhe anëtarë të personelit administrativ.

Tabela 1. Pasqyrë e strukturës së personelit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës para dhe pas dorëheqjeve masive

Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe degët e saj	Shtator 2022			Qershor 2023		
	Mitrovicë	Leposaviq	Zubin Potok	Mitrovicë	Leposaviq	Zubin Potok
Gjyqtarë	33	2	2 ¹⁷	18 ¹⁸	0	0
Shqiptarë të Kosovës	16	0	0	17	0	0
Serbë të Kosovës	17	2	2	0	0	0
Burra	18	1	1	10	0	0
Gra	15	1	1	8	0	0
Personeli administrativ	148 ¹⁹	20	24	79 ²⁰	0	3
Shqiptarë të Kosovës	78	0	2	76	0	3
Serbë të Kosovës	65	20	26	0	0	0
Burra	65	13	14	37	0	2
Gra	83	7	14	42	0	1

Nga Prokuroria Themelore e Mitrovicës, si pjesë e dorëheqjeve masive, më 7 nëntor 2022, 10 prokurorë serbë të Kosovës dhe 22 anëtarë të personelit administrativ kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre.

17 Grupi i Kërkimit të Politikave në Ballkan, Platforma Dialog-Info. Shtojca e Marrëveshjes së Drejtësisë, 2015. Në dispozicion në: <https://dialogue-info.com/wp-content/uploads/2013/04/integration-of-judiciary.jpg> (qasur më 15 shtator 2023).

18 Përfshirë një gjyqtare boshnjake të Kosovës.

19 Përfshirë katër punonjëse gra boshnjake të Kosovës dhe një punëtor goran të Kosovës.

20 Përfshirë tre punonjëse gra boshnjake të Kosovës.

Tabela 2. Pasqyrë e strukturës së personelit të Zyrës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës para dhe pas dorëheqjeve masive

Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës	Shtator 2022	Qershor 2023
Prokurorë	19	10
Shqiptarë të Kosovës	9	10
Serbë të Kosovës	10	0
Burra	9	6
Gra	10	4
Personeli administrativ	65	47²¹
Shqiptarë të Kosovës	43	47
Serbë të Kosovës	22	0
Burra	34	26
Gra	31	21

2.4.2. Ngarkesa me lëndë

Më 7 nëntor 2022, një numër i madh i gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ lanë pozitat e tyre në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj në Leposaviq dhe Zubin Potok, Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicë Veriore dhe Zyrën e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës. Pashmangshëm që kjo ka ndikuar në funksionimin e përgjithshëm, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë në rajonin e Mitrovicës.

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Për sa i përket ngarkesës së lëndëve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës pas dorëheqjeve masive, 1520 lëndë penale dhe mbi 5000 lëndë civile të caktuara për gjyqtarët serbë të Kosovës është të ricaktohen te gjyqtarët shqiptarë të Kosovës.²² Gjatë procesit të dorëheqjeve masive, gjyqtarët serbë të Kosovës identifikuan lëndët më urgjente që u ishin caktuar atyre dhe i dorëzuan shkresat përkatëse të lëndëve gjyqtarëve shqiptarë të Kosovës për të siguruar përpunimin e duhur dhe me kohë të lëndëve të tilla urgjente.

²¹ Përfshirë tre punonjës boshnjakë të Kosovës.

²² 700 lëndë penale u janë caktuar gjyqtarëve serbë të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe 820 lëndë penale gjyqtarëve serbë të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Mitrovicës.

Një krahasim sasior i të dhënave statistikore ndihmon në shqyrtimin e ndikimit të mundshëm të dorëheqjeve masive në ngarkesën e lëndëve në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Më konkretisht, të dhënat e publikuara në raportin e KGJK-së për punën e kësaj gjykate në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, pra para dorëheqjeve masive, dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, gjegjësisht pas dorëheqjeve masive, tregojnë një rënie të konsiderueshme të normës së përgjithshme të zgjidhjes së të gjitha llojeve të lëndëve.²³

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2022, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka pranuar 3574 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 2686 lëndë, me një normë të përgjithshme të zgjidhjes së të gjitha llojeve të lëndëve prej 75%. Në anën tjetër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2023, Gjykata Themelore e Mitrovicës ka pranuar 3214 lëndë të reja dhe ka zgjidhur 1899 lëndë, me normë të përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve prej 59%.

Një analizë më e hollësishme tregon se rënia e normës së zgjidhjes ka të bëjë kryesisht me Lëndët e krimeve të përgjithshme, lëndët e kontesteve civile dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Sa i përket lëndëve penale të përgjithshme në procedurën paraprake, nuk ka pasur rënie të konsiderueshme sasiore në normën e përgjithshme të zgjidhjes. Nga 89% në gjysmën e parë të vitit 2022, lëviz në 86% në gjysmën e parë të vitit 2023, por pati rënie të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pranuar, nga 115 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2022 në vetëm 66 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2023.

Për sa i përket lëndëve të krimeve të përgjithshme në shqyrtim gjyqësor, të dhënat statistikore tregojnë për një rënie të dukshme në normën e përgjithshme të zgjidhjes nga 117 % në gjysmën e parë të vitit 2022 në 74 % në gjysmën e parë të vitit 2023. Gjithashtu, është shënuar rënie në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pranuar, nga 436 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2022 në 270 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2023.

Një krahasim i të dhënave statistikore të gjysmës së parë të vitit 2022 me të njëjtën periudhë të vitit 2023 tregon se lëndët e krimeve të rënda dhe lëndët penale me të mitur pësuan rënie në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pranuar, por ka pasur rritje në normën e zgjidhjes.

Kur bëhet fjalë për lëndët e kontesteve civile, të dhënat statistikore tregojnë për një rënie në normën e përgjithshme të zgjidhjes nga 61% në gjysmën e parë të

²³ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, Vjetor 2022*. Në dispozicion në: [45114_RAPORTI STATISTIKOR I GJYKATAVE VJETOR 2022.pdf \(gjyqesori-rks.org\)](#) (qasur më 31 korrik 2023).

vitit 2022 në 52% në gjysmën e parë të vitit 2023. Gjithashtu është shënuar një rënie e numrit të përgjithshëm të lëndëve të pranuar, nga 1098 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2022 në 885 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2023.

Për sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, të dhënat statistikore tregojnë për një rënie të konsiderueshme të normës së përgjithshme të zgjidhjes nga 64 % në gjysmën e parë të vitit 2022 në 25 % për të njëjtën periudhë të vitit 2023. Në lidhje me këtë rënie të normës së zgjidhjes, numri i vendimeve gjyqësore në pritje të përmbartimit 'u rrit nga 2550 lëndë të pazgjidhura deri në qershor të vitit 2022 në 3901 lëndë të pazgjidhura deri në qershor të vitit 2023.

Tabela 3. Krahasimi i ngarkesës së lëndëve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës

Gjykata Themelore e Mitrovicës	Janar – Qershor 2022			Janar – Qershor 2023		
	Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	Norma e zgjidhjes % ²⁴	Lëndët e pranuar në periudhën raportuese	Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	Norma e zgjidhjes %
Lëndët e krimeve të përgjithshme në procedurë paraprake	115	102	89	66	57	86
Lëndët e krimeve të përgjithshme në shqyrtim gjyqësor	436	508	117	270	201	74
Lëndët e krimeve të rënda në procedurë paraprake	120	99	83	108	129	119
Lëndët e krimeve të rënda në shqyrtim gjyqësor	161	177	110	120	265	221
Lëndët për të mitur në procedurë paraprake	22	21	95	33	27	82
Lëndët për të mitur në shqyrtim gjyqësor	75	30	40	38	24	63
Lëndë të kontesteve civile	1098	675	61	885	457	52
Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore	1133	729	64	1353	333	25
Të gjitha llojet e lëndëve	3574	2686	75	3214	1899	59

²⁴ Norma e zgjidhjes është raporti ndërmjet numrit të lëndëve që janë zgjidhur në periudhën raportuese dhe numrit të lëndëve që janë pranuar rishtazi në periudhën raportuese.

Që nga dorëheqjet masive, objektet e degëve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq dhe Zubin Potok janë mbyllur pasi të gjithë gjyqtarët serbë të Kosovës të caktuar në këto degë të gjykatave kanë dhënë dorëheqje, së bashku me gjithë personelin administrativ serb të Kosovës. Në bazë të planit të përkohshëm të veprimit të datës 9 nëntor, katër gjyqtarë shqiptarë të Kosovës të Gjykatës Themelore të Mitrovicës trajtojnë të gjitha lëndë penale dhe civile nën juridiksionin e këtyre degëve të gjykatave.

Sipas të dhënave statistikore të publikuara në raportet e KGJK-së për punën e këtyre degëve të Gjykatës Themelore të Mitrovicës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, të dyja degët e gjykatave kanë pësuar rënie të numrit të përgjithshëm të lëndëve të pranuar. Gjithashtu, ato pësuan rënie të konsiderueshme në normën e përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve.

Më konkretisht, dega e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Leposaviq raportoi për një rënie të numrit të përgjithshëm të lëndëve të pranuar, nga 199 në 45 lëndë dhe për një rënie në normën e përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve nga 75 % në 20 %. Ngjashëm, dega e Gjykatës Themelore të Mitrovicës në Zubin Potok raportoi për një rënie të numrit të përgjithshëm të lëndëve të pranuar, nga 118 në tri lëndë, si dhe për një rënie në normën e përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve nga 74 % në 0 %.²⁵

Zyra e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

Për sa i përket ngarkesës me lëndë në Zyrën e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës pas dorëheqjeve masive, gjithsej 5302 lëndë penale të të gjitha llojeve të caktuara për prokurorët serbë të Kosovës duhej t'u caktoheshin sërish prokurorëve shqiptarë të Kosovës.

Në vlerësimin e ndikimit të mundshëm të dorëheqjeve masive në ngarkesën e lëndëve në Zyrën e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, krahasimi sasior i të dhënave statistikore të publikuara në raportin e punës së Prokurorisë së Kosovës për gjysmën e parë të vitit 2022, pra para dorëheqjeve masive, dhe raportet e KPK për punën e kësaj prokurorie për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, gjegjësisht pas dorëheqjeve masive, tregojnë për një rënie të normës së përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve.

Për ta shtjelluar më shumë, në gjysmën e parë të vitit 2022, Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ka pranuar 2836 lëndë të reja – kallëzime penale, prej të

²⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, Vjetor 2022*. Në dispozicion në: 45114_RAPORTI STATISTIKOR I GJYKATAVE VJETOR 2022.pdf (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

cilave janë zgjidhur 2117 lëndë, me një normë të përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve prej 75%.²⁶ Në anën tjetër, në gjashtë muajt e parë të vitit 2023, Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ka pranuar 1236 lëndë-kallëzime penale të reja, prej të cilave janë zgjidhur 709 lëndë, me një normë të përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve prej 57%.²⁷

Në mënyrë më të hollësishme, nga janari deri në mars të vitit 2023, Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka raportuar 528 lëndë - kallëzime penale të reja, prej të cilave 458 lëndë janë zgjidhur, me një normë të përgjithshme të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve prej 87%. Nga prilli deri në qershor të vitit 2023, Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka raportuar 708 lëndë -kallëzime penale të reja, prej të cilave 251 lëndë janë zgjidhur, me një normë të zgjidhjes për të gjitha llojet e lëndëve prej 35,45%.

Gjithashtu, kur bëhet krahasimi i numrit të përgjithshëm të lëndëve- kallëzimeve penale të reja të pranuar në gjysmën e parë të vitit 2022 dhe në gjysmën e parë të vitit 2023, të dhënat statistikore tregojnë për një rënie nga 2836 lëndë-kallëzime penale të reja në 1236 lëndë- kallëzime penale të reja, që paraqet një rënie prej 43%.

2.4.3. Lëndët e pazgjidhura

Gjykata Themelore në Mitrovicë

Numri i madh i lëndëve të pazgjidhura gjyqësore është sfidë e vazhdueshme me të cilën Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe degët e saj përballën për një kohë të gjatë.²⁸

Për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të dorëheqjeve masive në grumbullimin e lëndëve gjyqësore, të dhënat statistikore të publikuara në raportet e KGJK-së për punën e kësaj gjykate në vitin 2022 para dorëheqjeve masive dhe për gjysmën e parë të vitit 2023 pas dorëheqjeve masive ilustrojnë trendin e rënies së normës së zgjidhjes së lëndëve të pranuar rishtazi dhe një rritje të lëndëve të pazgjidhura

²⁶ Zyra e Kryeprokurorit të Kosovës, *Raporti gjashtëmuajor për punën e prokurorit, janar – qershor 2022*. Në dispozicion në: [170.pdf \(prokuroria-rks.org\)](https://prokuroria-rks.org) (qasur më 15 shtator 2023).

²⁷ Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit të PTH Mitrovicë, korrik-shtator 2022*. Në dispozicion në: [Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit të PTH Mitrovicë, periudha korrik-shtator 2022, nr.1793.2022.pdf \(prokuroria-rks.org\)](https://prokuroria-rks.org) (qasur më 15 shtator 2023).

²⁸ Në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, në vitin 2018 numri i lëndëve të pazgjidhura ishte 8929; në vitin 2019 ishin 8642 lëndë të pazgjidhura; në vitin 2020 ishin 8279 lëndë të pazgjidhura; dhe në vitin 2021 numri i lëndëve të pazgjidhura ishte 10745.

për të gjitha llojet e lëndëve nga fillimi i vitit 2022 deri në gjysmën e parë të vitit 2023.

Në mënyrë më të hollësishme, nga janari deri në qershor të vitit 2022, gjykata ka arritur një normë të zgjidhjes prej 75,15%, duke lënë një ngarkesë prej 11487 lëndëve të pazgjidhura. Mu përpara dorëheqjeve masive, deri në shtator të vitit 2022, norma e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata ishte 79,62%, me një ngarkesë prej 11497 lëndëve të pazgjidhura. Pas dorëheqjeve masive, deri në dhjetor të vitit 2022, norma e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata pësoi rënie në 74,43%, me ngarkesë prej 12172 lëndëve të pazgjidhura.²⁹ Nga janari deri në qershor të vitit 2023, norma e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata vazhdoi të pësojë rënie gradualisht në 59%, duke lënë një ngarkesë prej 13313 lëndësh të pazgjidhura.³⁰

Këto shifra tregojnë se dorëheqja masive ndikoi drejtpërdrejt në kapacitetet e Gjykatës Themelore të Mitrovicës për t'i trajtuar lëndët me kohë. Në vitin 2022, rritja e përgjithshme e ngarkesës ishte 1694 lëndë të pazgjidhura, ndërsa vetëm në gjysmën e parë të vitit 2023, rritja e përgjithshme e ngarkesës ishte tashmë në 1315 lëndë të pazgjidhura.

Për sa i përket rënies së normës së zgjidhjes të lëndëve dhe rritjes së numrit të lëndëve të pazgjidhura pas dorëheqjeve masive, është e dukshme edhe një rënie e ndjeshme e numrit të lëndëve të zgjidhura. Në tre muajt e parë të vitit 2022, gjykata ka zgjidhur 1475 lëndë³¹; në tre muajt e parë të vitit 2023 gjykata ka zgjidhur vetëm 1032 lëndë³². Nga janari deri në qershor të vitit 2022, gjykata ka zgjidhur 2686 lëndë; megjithatë, gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2023, gjykata ka zgjidhur vetëm 1899 lëndë. Rënia e numrit të lëndëve të zgjidhura pas dorëheqjeve masive është edhe më e dukshme kur merren parasysh vetëm të dhënat nga prilli deri në qershor 2023, kur gjykata zgjidhi vetëm 867 lëndë, me një normë të zgjidhjes prej 52,83 për qind, me pranimin e 1641 lëndëve të reja.³³

29 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, janar-shtator 2022*. Në dispozicion në: [17924_KGJK_Raporti_statistikor_gjykatave_nentemujori_2022.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023); Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, Vjetor 2022*. Në dispozicion në: [45114_RAPORTI STATISTIKOR I GJYKATAVE VJETOR 2022.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

30 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, janar-qershor 2023*. Në dispozicion në: [62812_KGJK_Raporti_statistikor_gjykatave_gjashtemujor_pare_2023.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

31 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, janar-mars 2022*. Në dispozicion në: [86839_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Tremujorit_pare_2022.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

32 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, janar-mars 2023*. Në dispozicion në: [15988_KGJK_Raporti_statistikor_tremujorit_pare_2023_mbi_punen_gjykatave.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

33 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor i Punës së Gjykatave, janar-qershor 2023*. Në dispozicion në: [62812_KGJK_Raporti_statistikor_gjykatave_gjashtemujor_pare_2023.pdf](#) (gjyqesori-rks.org) (qasur më 31 korrik 2023).

Tabela 4. Pasqyrë e lëndëve të pazgjidhura në Gjykatën Themelore të Mitrovicës

Gjykata Themelore e Mitrovicës	Lëndët e zgjidhura në periudhën raportuese	Norma e zgjidhjes %	Lëndët e pazgjidhura deri në fund të periudhës raportuese
Janar – Mars 2022	1,475	94	10,695
Janar – Qershor 2022	2,696	75,15	11,487
Janar – Shtator 2022	3,931	79,62	11,497
Janar – Dhjetor 2022	4,930	74,43	12,172
Janar – Mars 2023	1,032	65,61	12,585
Janar – Qershor 2023	1,899	59	13,313

Degët e GJTH të MI-së në Leposaviq dhe Zubin Potok, objektet e të cilave janë mbyllur që nga nëntori i vitit 2022, gjithashtu kanë pësuar rënie të numrit të lëndëve të pranuar, numrit të lëndëve të zgjidhura dhe normës së zgjidhjes.³⁴

Prokuroria Themelore e Mitrovicës

Për sa i përket ndikimit të mundshëm të dorëheqjes masive në numrin e lëndëve të pazgjidhura, krahasimi sasior i të dhënave statistikore të publikuara në raportet e Prokurorisë së Kosovës për punën e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës në vitin 2022, pra para dorëheqjes masive, dhe raporti i KPK-së për punën e kësaj prokurorie në gjysmën e parë të vitit 2023, pra pas dorëheqjes masive, tregon rënie të ndjeshme të shkallës së trajtimit të lëndëve të reja pranuar dhe rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura të të gjitha llojeve në gjashtë muajt e parë të vitit 2023.

Konkretisht, gjatë vitit 2022, prokuroria ka mbajtur normën e zgjidhjes së lëndëve të reja të pranuar në një mesatare prej 75%, me numër të përgjithshëm prej 8,041 lëndësh të pazgjidhura deri në dhjetor 2022³⁵. Përkundrazi, në gjysmën e parë të 2023, shkalla e shqyrtimit të lëndëve të sapo pranuar kishte rënë në 57%,³⁶ duke rritur ngarkesën e përgjithshme të lëndëve të pazgjidhura në 9,042 deri në qershor 2023.³⁷

34 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor për Punën e Gjykatave, Vjetor 2022*. Gjetet në: 45114_RAPORTI STATISTIKOR I GJYKATAVE VJETOR 2022.pdf (gjyqesori-rks.org) (shikuar më 31 korrik 2023); Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raport Statistikor për Punën e Gjykatave, janar-qershor 2023*. Gjetet në:

76394_KGJK_Raporti_statistikor_gjykatave_gjashtemuajor_pare_2023_SRB.pdf (gjyqesori-rks.org) (shikuar më 31 korrik).

35 Prokuroria e Kosovës, *Raporti Vjetor i Prokurorit të Shtetit 2022*. Gjetet në: RAPORTI VJETOR I PROKURORIT TE SHETIT 2022.pdf (prokuroria-rks.org) (shikuar më 28 shtator 2023).

36 Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Mekanizmi Raportues i Kryeprokurorit të MI BPO, janar-mars 2023*. Gjetet në: Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit PTH Mitrovicë, periudha janar-mars 2023.pdf (prokuroria-rks.org) (shikuar më 28 shtator); Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Mekanizmi Raportues i Kryeprokurorit të MI BPO, Prill - Qershor 2023*. Gjetet në: Nr.1207.2023-Mekanizmi i Raportimit të Kryeprokurorit të PTh. Mitrovicë.pdf (prokuroria-rks.org) (shikuar më 28 shtator).

37 Numri i lëndëve të mbetura të pazgjidhura është marrë nga Prokuroria Themelore e Mitrovicës.

Këto të dhëna nënkuptojnë se dorëheqja masive kishte pasojë të drejtpërdrejtë në efikasitetin e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës pasi në vitin 2022 rritja e përgjithshme e lëndëve të pazgjidhura ishte 1,235 lëndë, ndërsa vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit 2023, rritja e përgjithshme e lëndëve të pazgjidhura ishte 1,001.

Kur krahasojmë gjysmën e parë të vitit 2022 dhe gjysmën e parë të vitit 2023, është evidente se edhe numri i lëndëve të zgjidhura pranë Prokurorisë Themelore të Mitrovicës ka pësuar rënie. Nga janari deri në qershor 2022, prokuroria kishte zgjidhur 2,117 lëndë,³⁸ ndërsa nga janari deri në qershor 2023, prokuroria ka zgjidhur vetëm 709 lëndë, që paraqet një rënie të dukshme.³⁹

Tabela 5. Pasqyrë i lëndëve të pazgjidhura të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë

PTH MI	Lëndët e zgjidhura gjatë periudhës së raportimit	Norma e zgjidhjes %	Lëndë të pazgjidhura deri në fund të periudhës së raportimit
Janar – Qershor 2022	2,117	74,64	7,525
Janar – Shtator 2022	3,060	75,22	7,814
Janar – Dhjetor 2022	4,863	74,60	8,041
Janar – Qershor 2023	709	57	9,042

2.4.4. Seancat e shtyra

Në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe në të gjitha degët e saj, dorëheqja masive çoi menjëherë në një situatë ku seancat në lëndët që i ishin caktuar gjyqtarëve serbë të Kosovës, lëndët e gjykuara nga panelet e përbëra nga gjyqtarë serbë të Kosovës, apo lëndët e përfaqësuara nga prokurorët serbë të Kosovës nuk u mbajtën ose u shtynë.

Bazuar në të dhënat e disponueshme përmes faqes zyrtare të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, nga 7 nëntori 2022 deri në fillim të vitit 2023, të paktën 191 seanca në lëndët që u ishin caktuar gjyqtarëve serbë të Kosovës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj në Leposaviq dhe Zubin Potok nuk u mbajtën për shkak të mungesës së tyre.⁴⁰

38 Prokurori i Shtetit, *Raporti gjashtëmuor i punës së Prokurorit të Shtetit janar-qershor 2022*. Gjendet në: 170.pdf (prokuroria-rks.org) (shikuar më 28 shtator).

39 Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Mekanizmi Raportues i Kryeprokurorit të MI BPO, janar-mars 2023*. Gjendet në: Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit PTH Mitrovicë, periudha janar-mars 2023.pdf (prokuroria-rks.org) (shikuar më 28 shtator).

40 Gjykata Themelore e Mitrovicës, *Orari i seancave gjyqësore*. Në dispozicion në: Orari i seancave – Gjykata Themelore Mitrovicë (gjyqesori-rks.org); Raspored sudskih saslušanja – Gjykata Themelore Mitrovicë (gjyqesori-rks.org) (shikuar më 31 korrik).

Ndonëse degët e GJK të MI-së në Skenderaj dhe Vushtrri nuk kishin gjyqtarë të integruar serbë të Kosovës të caktuar për të punuar atje, menjëherë pas dorëheqjes masive, OSBE-ja monitoroi disa shtyrje të seancave në lëndë penale për shkak të mungesës së prokurorëve serbë të Kosovës të cilët paraqitën dorëheqje. Për shembull, më 9 nëntor 2022, një gjyqtar shqiptar i Kosovës shtyu seancën fillestare në një lëndë penale të shpërdorimit të pronës së huaj⁴¹ për datën 9 dhjetor 2022, pasi prokurori serb i Kosovës që përfaqësonte lëndën nuk u paraqit për shkak të dorëheqjes masive.

Menjëherë pas dorëheqjes masive, mungesa e prokurorëve serbë të Kosovës ndikoi në masë të madhe në Departamentin e Përgjithshëm të GJTH-së së MI-së, ku kishte mbetur vetëm një prokuror shqiptar i Kosovës për të trajtuar të gjitha lëndët penale, pasi shumica e prokurorëve serbë të Kosovës ishin caktuar në këtë departament. Për të ilustruar seriozitetin e situatës, në shtator të vitit 2022, Departamenti i Përgjithshëm i GJTH-së së MI-së kishte 10 prokurorë shqiptarë dhe serbë të Kosovës.⁴²

Nga janari deri në qershor 2023, gjendja e Departamentit të Përgjithshëm të GJTH-së së MI-së ishte sfiduese meqë vetëm katër prokurorë shqiptarë të Kosovës trajtonin të gjitha lëndët penale. Ky reduktim i vazhdueshëm i kapaciteteve të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës shkaktoi rritje të numrit të seancave në lëndët penale të shtyra për shkak të numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve. Ky trend iu konfirmua OSBE-së nga nënkryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të dy gjyqtarët mbikëqyrës të degëve të GJTH të MI-së në Skenderaj dhe Vushtrri, si dhe nga kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës.

2.5. Ndikimi i dorëheqjeve masive në funksionimin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë

Dorëheqja masive e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës të caktuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, Divizionin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës krijoi një situatë të jashtëzakonshme, duke shkaktuar pasoja serioze për funksionimin e përgjithshëm, efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë në rajonin e Mitrovicës.

⁴¹ KP 2019, neni 318 (1), shpërdorimi i pasurisë së tjetrit

⁴² Këshilli Prokurorial i Kosovës, *Mekanizmi Raportues i Kryeprokurorit të MI BPO, korrik-shtator 2022..* Gjetet në: Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit të PTH Mitrovicë, periudha korrik-shtator 2022, nr.1793.2022.pdf (prokuroria-rks.org), (shikuar më 25 shtator).

Ndikimet afatmesme të dorëheqjes masive

Menjëherë pas dorëheqjes masive, nuk u mbajtën seancat dëgjimore në lëndët që u ishin caktuar gjyqtarëve serbë të Kosovës, lëndët e shqyrtuara nga panelet në përbërje të të cilave ishte së paku një gjyqtar serb i Kosovës, ose lëndët që në ditën e dorëheqjes masive përfaqësoheshin nga prokurorë serbë të Kosovës në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe degët e saj. Për më tepër, u shtynë ose anuluan të gjitha seancat në lëndët që u janë caktuar gjyqtarëve serbë të Kosovës që tashmë ishin caktuar të mbaheshin në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe degët e saj në Leposaviq dhe Zubin Potok deri në fillim të vitit 2023.

Dorëheqja e 10 prokurorëve serbë të Kosovës reduktoi ndjeshëm kapacitetin e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, veçanërisht Departamentit të saj të Përgjithshëm, gjë që përfundimisht çoi në rritje të numrit të seancave të shtyra në lëndët penale si pasojë e mungesës së vazhdueshme të prokurorëve shqiptarëve të Kosovës.

Pas dorëheqjes masive në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj në Leposaviq dhe Zubin Potok, gjithsej 1,520 lëndë penale dhe mbi 5,000 lëndë civile të caktuara për gjyqtarët serbë të Kosovës iu ricaktuan gjyqtarëve shqiptarë të Kosovës. Pas këtij ricaktimi, çdo lëndë gjyqësore duhej të fillonte nga e para.⁴³ Në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, 5,302 lëndë penale të caktuara për prokurorët serbë të Kosovës iu ricaktuan prokurorëve shqiptarë të Kosovës. Në situatën e mungesës së vazhdueshme të personelit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, një ricaktim i tillë i lëndëve jo vetëm që rriti ngarkesën e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë të Kosovës, por edhe mund të ketë kontribuar në zvarritjen e lëndëve, duke ndikuar kështu negativisht në parimin themelor të gjykimit të drejtë dhe në kohë për palët.

Bazuar në planin e përkohshëm të veprimit, Gjykata Themelore e Mitrovicës transferoi 81 lëndë në gjykatat tjera themelore në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Pejë dhe Prizren. Një transferim i tillë i jashtëzakonshëm i lëndëve në Gjykatat Themelore në rajone tjera të Kosovës solli sfida për sa i përket qasjes në drejtësi për pjesëmarrësit, dëshmitarët dhe përfaqësuesit ligjorë. Kërkesat logjistike të udhëtimit në gjykata të tjera themelore mund të kenë ndikuar në mundësinë që palët të marrin pjesë në mënyrë efektive në procedura gjyqësore; rritja e kostos së udhëtimit mund të ketë qenë veçanërisht e rëndë për pjesëmarrësit që jetojnë në zona rurale ose të largëta.

⁴³ 2013 KPP neni 311, 2023 KPP neni 307

Sipas planit të përkohshëm të veprimit në fuqi deri në prill 2023, të gjithë gjyqtarët u udhëzuan që t'i prioritizojnë lëndët e paraburgimit, lëndët penale dhe civile të dhunës në familje dhe lëndët që rrezikojnë parashkrimin. Ndërsa një strategji e tillë me fokus në lëndë specifike gjithësesi i shërben qëllimit të zgjidhjes së shpejtë dhe vëmendjes së përqendruar në lëndët urgjente ose të ndjeshme, ajo me gjasë ka çuar edhe në një situatë të vonësive procedurale në lëndët më pak urgjente ose më pak serioze. Kjo ndikon në të drejtat e barabarta të palëve dhe mund të çojë në perceptimin e qasjes së pabarabartë në drejtësi. Në të njëjtin drejtim, Prokuroria Themelore e Mitrovicës ka miratuar një masë të ngjashme për prioritizimin e paraburgimit në lëndët me paraburgim, lëndët e dhunës në familje, lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, si dhe lëndët që kanë arritur afatet kohore të hetimit.

Ndikimet afatgjata të dorëheqjes masive

Kapaciteti i Gjykatës Themelore në Mitrovicë u zvogëluar ndjeshëm meqë dorëheqja masive solli një rënie të madhe në normën e përgjithshme të zgjidhjes të llogaritur ndërmjet lëndëve të pranuar rishtazi dhe atyre të zgjidhura, nga 79.62% deri në shtator 2022 në 59% deri në qershor 2023, si dhe rritje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura, nga 11,497 deri në shtator 2022 në 13,313 lëndë deri në qershor 2023. Numri i lëndëve të zgjidhura gjithashtu ka shënuar rënie nga 2,696 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2022 në 1,899 lëndë në gjysmën e parë të 2023. Mbyllja e objekteve të degëve të GJTH të MI-së në Leposaviq dhe Zubin Potok e përkeqësuan më tej situatën e jashtëzakonshme, duke krijuar barriera serioze për qasje në drejtësi. Kjo përfshin qasje të kufizuar fizike për banorët e këtyre komunave, rënie të vazhdueshme të normës së zgjidhjes ndërmjet lëndëve të pranuar rishtazi dhe lëndëve të zgjidhura, si dhe rritje të numrit të përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura.

Ngjashëm sikurse në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, dorëheqja masive zvogëloi ndjeshëm kapacitetet e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, duke shkaktuar rënie në normën e përgjithshme të zgjidhjes së llogaritur ndërmjet lëndëve të pranuar rishtazi dhe atyre të zgjidhura nga 75,22 % deri në shtator 2022, në 57% deri në qershor 2023 dhe një rritje në numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura nga 7,814 deri në shtator 2022, në 9,042 deri në qershor 2023. Numri i lëndëve të zgjidhura gjithashtu pësoi rënie nga 2,117 lëndë në gjysmën e parë të 2022, në 709 lëndë në gjysmën e parë të vitit 2023.

Përfundimisht, dorëheqja masive sfidoi zbatimin e "Marrëveshjes së Brukselit 2013" dhe "Marrëveshjes së Drejtësisë 2015". Të dyja këto marrëveshje përcaktojnë qartë kuotën dhe përkatësinë etnike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të caktuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, Divizionin e Gjykatës së Apelit në

Mitrovicën Veriore, si dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës. Për zbatimin e duhur të të dyja marrëveshjeve, pozitat për të cilat janë dorëzuar dorëheqjet duhet t'u caktohen gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit administrativ serbë të Kosovës.

3. PËRFUNDIME

Dorëheqja masive e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës nga pozitat e tyre në gjyqësorin dhe prokurorinë e integruar në rajonin e Mitrovicës ka krijuar një situatë të jashtëzakonshme e cila vazhdon të ketë efekte të gjera dhe negative në sistemin e drejtësisë në Mitrovicës dhe në parimet e gjykimit të drejtë, veçanërisht në lidhje me të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme dhe qasjen në drejtësi.

Dorëheqja masive menjëherë rezultoi me ndërprerje të atypëratyshme të procedurave gjyqësore, ku nuk u mbajtën seancat gjyqësore në lëndët e caktuara për gjyqtarët dhe prokurorët serbë të Kosovës. Kjo ndërprerje vazhdoi për një periudhë të gjatë, duke çuar në shtyrje të një numri të konsiderueshëm të seancave gjyqësore.

Në të njëjtin kuptim, numri vazhdimisht i pamjaftueshëm i prokurorëve shqiptarë të Kosovës për t'i zëvendësuar homologët e tyre serbë ka krijuar vështirësi operative brenda Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, veçanërisht Departamentit të saj të Përgjithshëm, i cili nga ana tjetër kontribuoi në rritjen e numrit të seancave të shtyra në lëndët penale.

Një numër i madh i lëndëve penale dhe civile, që fillimisht iu caktuan gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës, iu ricaktuan gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë të Kosovës. Ky ricaktim, i shoqëruar me mungesën e personelit në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, çoi në ngarkesë të shtuar për gjyqtarët dhe prokurorët shqiptarë të Kosovës dhe në vonesa potenciale të lëndëve, gjë që kishte ndikim për sa i përket ndarjes së drejtësisë në kohë.

Si përgjigje ndaj dorëheqjes masive, Gjykata Themelore e Mitrovicës transferoi lëndët e përzgjedhura gjyqësore në gjykata të tjera themelore në rajone të ndryshme të Kosovës. Kjo masë sfidoi qasjen në drejtësi për pjesëmarrësit, dëshmitarët dhe përfaqësuesit ligjorë, meqë udhëtimi në gjykata të largëta dhe rritja e kostos mund të ketë pasur ndikim në aftësinë e tyre për t'iu qasur drejtësisë në mënyrë efektive.

Gjykata Themelore e Mitrovicës dhe Prokuroria Themelore e Mitrovicës kanë zbatuar masë lehtësuese të prioritizimit të lëndëve specifike, siç janë ato me paraburgim, lëndët e dhunës në familje dhe ato që i afrohen parashkrimit apo afatit të hetimit. Ndonëse me të drejtë synimi për zgjidhjen e shpejtë të lëndëve urgjente, në të njëjtën kohë, kjo strategji ngriti shqetësime për vonesat e

mundshme procedurale në lëndët më pak urgjente dhe perceptimin e mundshëm të qasjes së pabarabartë në drejtësi për qytetarët.

Dorëheqja masive reduktoi ndjeshëm kapacitetin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, duke shkaktuar ulje të normës së zgjidhjes, rritje të dukshme të numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe rënie të numrit të lëndëve të zgjidhura. Një situatë e tillë ka ndikim të theksuar në qasjen në drejtësi dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë në Mitrovicë.

Dorëheqja masive paraqet një kthim serioz prapa në sistemin e drejtësisë në Mitrovicë, pas integritit të suksesshëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ serbë të Kosovës në sistem të drejtësisë më 2017. Kjo situatë e jashtëzakonshme, e cila ende vazhdon, rezultoi në atë që Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe Zyra e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë funksionin me kapacitet të reduktuar për shkak të mungesës së vazhdueshme të personelit. Rënia e dukshme e normës së zgjidhjes së lëndëve të të dyja institucioneve, ndërprerjet në procedurat gjyqësore, zvarritja e lëndëve dhe vështirësitë e qasjes në drejtësi për banorët nënvizojnë nevojën kritike për masa për adresimin e këtyre sfidave dhe për të rivendosur funksionimin efikas dhe të drejtë të sistemit të drejtësisë në Mitrovicë.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë